

***AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME NJE ORTAK
"Tre L" SHPK***

**AKTI I THEMELIMIT TE
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Tre L" SHPK**

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME NJE ORTAK
"Tre L" SHPK

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME NJE ORTAK
"Tre L" SHPK

Sot me datën 15/09/2021 (dymijë e njëzet e një), ne ortakët themelues:

- **Znj. Silvana Dauti** e bija e Maliqit, shtetase shqiptare, e datëlindjes 25 Nëntor 1973, lindur në Fier, dhe banues në Vlorë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Letërnjoftimit (kartë identiteti) me Nr. Letërnjoftimi/karte H36125089N.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me një ortak " Tre L" Shpk.

NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet "Tre L" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në "Lagjia Kryengritja e Fierit, Rruga Hasan Tahsini ish Uzina e Pambukut Pasuria me Nr 8/743, Z.K 8531, Fier".

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e:

- a. Prerje e qepje (orlature) të pjesëve të ndryshme të këpucëve, sandaleve, çizmeve, shapkave, atleteve për të gjitha stinët si dhe tregtimin dhe eksportimin e tyre.
- b. Import - eksport me shumice dhe pakice të mallrave të ndryshëm industriale.
- c. Aktiviteti i transportit të mallrave të mësipërme me mjete të ndryshme.



AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME NJE ORTAK
"Tre L" SHPK

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "**Tre L**" Shpk është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kontributi i ortakëve është i ndarë si vijon:

1. Silvana Dauti zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.

NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

NENI 6
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë **Znj. Silvana Dauti**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm



AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME NJE ORTAK
"Tre L" SHPK

personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8
NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9
LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqiptar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Ne rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Fier për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES I SHOQËRISË
" Tre L" SH.P.K

Silvana Dauti



Datë 15.09.2021